



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.06.2023)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës. (shtyrë nga mbledhjet plenare të datave 22.12.2022, 19.01.2023, 13.02.2023, 6.03.2023, 05.04.2023, 08.05.2023, 06.06.2023).

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor nr. 1/2023, ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës (shtyrë nga mbledhja plenare e datës 05.04.2023, 08.05.2023, 06.06.2023).

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor nr. 2/2023, ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës (shtyrë nga mbledhja plenare e datës 05.04.2023, 08.05.2023, 06.06.2023).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:16 dhe mbaroi në orën 12:21.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
2. *Klodian Kurushi* (anëtar)
3. *Irena Plaku* (anëtare)
4. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
5. *Ridvan Hado* (anëtar)
6. *Alban Toro* (anëtar)
7. *Marçela Shehu* (anëtare)
8. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Fatmira Luli*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.*
5. *{...} dhe {...}, përfaqësues të ILD-së.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

RENDI I DITËS:

1. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës. (shtyrë nga mbledhjet plenare të datave 22.12.2022, 19.01.2023, 13.02.2023, 6.03.2023, 05.04.2023, 08.05.2023, 06.06.2023).

2. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor nr. 1/2023, ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjirokastrë Kukës (shtyrë nga mbledhja plenare e datës 05.04.2023, 08.05.2023, 06.06.2023).

3. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor nr. 2/2023, ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjirokastrë Kukës (shtyrë nga mbledhja plenare e datës 05.04.2023, 08.05.2023, 06.06.2023).

Ilir Rusi: Mirëmëngjesi të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sipas njoftimit të bërë, sot do të zhvillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit të Lartë Gjyqësor, datë 21.06.2023, ora 10:00.

Paraprakisht ju njoftoj që Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor është me leje vjetore të zakonshme dhe për këtë arsye nuk mund të jetë prezent në mbledhjen e sotme dhe mbledhjen do ta drejtoj unë si Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Gjithashtu zonja Luli për shkak të një situatë familjare e ka të pamundur prezencën e saj fizike dhe “online” në këtë mbledhje për shkak të një fatkeqësie familjare, për shkak të ndërrimit të jetës së vëllait të vet.

Gjithashtu zonja Rupa, për arsye të lëvizshmërisë (është në trafik) dhe do jetë në lidhje “online” në këtë mbledhje të ditës së sotme.

Atëherë, sipas rendit të ditës, pika 1, 2 dhe 3 kanë të bëjnë me seancat dëgjimore në lidhje me procedimin disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjirokastrë Kukës, e cila është një seancë dëgjimore e shtyrë edhe në mbledhjet e mëparshme. Ka të bëjnë me procedimin disiplinor 3/2022. Gjithashtu kemi edhe zhvillimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor nr. 1/2023, ndaj magjistratit z. {...}, dhe zhvillimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor nr. 2/2023, ndaj magjistratit z. {...}.

Ftoj stafin të njoftojë përfaqësuesit e ILD-së për të qenë prezent në mbledhje.

(Futen në sallën e mbledhjes përfaqësuesit e ILD-së, z. {...} dhe z. {...}. Gjithashtu në sallë hyn edhe znj. Yllka Rupa.)

Ilir Rusi: Njëkohësisht, edhe për shkak të dinamikës, znj. Rupa është prezent në mbledhjen plenare të sotme të Këshillit të Lartë Gjyqësor, kështu që të shkëputet lidhja e saj “online” në mbledhje.

Njëkohësisht, konstatojmë që prezent, si përfaqësues të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë është z. {...} i cili kohë më parë ka marrë një autorizim për përfaqësimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në këtë procedim disiplinor të nisur ndaj z. {...} dhe rishtazi është lëshuar autorizimi nr. {...}, datë 20.06.2023, me qëllim që zonja {...} dhe zoti {...} të përfaqësojnë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë në procedimin nr. 3/2022, ndaj magjistratit z. {...}. Prezent është vetëm z. {...}.

Gjithashtu, me autorizimin nr. {...}, datë 05.06.2023, z. {...} është autorizuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë për të përfaqësuar Inspektorin e Lartë të Drejtësisë në procedimet disiplinore nr. 2 dhe nr. 3 të vitit 2023, ndaj zotit {...}, përkatësisht me autorizimet {...}, datë 05.05.2023 dhe nr. 1514, datë 05.05.2023.

Në kohë, referuar edhe seancës së mëparshme dëgjimore, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka bërë njoftimin z. {...} të shtyrjes së seancës dëgjimore të tij për shkak të paraqitjes së raportit mjekësor, i cili përfundon në datën 19.06.2023 dhe është njoftuar për zhvillimin e seancës së radhës dëgjimore e cila është e pazhvilluar me prezencën e tij por që ne kemi marrë masat për të zhvilluar këto seanca dëgjimore, dhe seanca e sotme është më datë 21.06.2023, ora 10:00.

Në eventualitet konstatoj faktin që njoftimet janë marrë nga familjari i zotit {...} (i ati i tij {...}), gjithashtu është marrë edhe nga nëpunësi përkatës i gjykatës në të cilën ai ushtron detyrën, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

Njëkohësisht në datën 20.06.2023, nëpërmjet e-mailit jemi njoftuar nga zoti {...} dhe konkretisht po citoj përmbajtjen e e-mailit: Kam dërguar raportet mjekësore të

marra nga Komisioni Mjekësor të cilat kanë përfunduar në datën 19.06.2023. Pas 180 ditësh raporte kam plotësuar dokumentacionin bashkëngjitur për të dalë në KEMP. Meqenëse Komisioni i KEMP-it mbledhet ditën e mërkurë, pra ditën e sotme datë 21.06.2023, pas orës 12:30, nuk është e mundur të merret raporti për këto ditë, por do të mbulohen nga raporti i KEMP-it. Me të marrë dokumentacionin e KEMP-it do ta njoftoj përsëri. Dhe na ka falënderuar.

Njëkohësisht ka dërguar edhe shkresën përkatëse e cila është shkresa me numër regjistri {...}, datë 12.06.2023, Komisioni Mjekësor i cili deri më tani e ka pajisur deri më tani z. {...} me raporte mjekësore që verifikojnë paaftësinë e përkohshme të tij për punë, e ka bashkëlidhur dhe e ka deleguar për kompetencë komisionit të KEMP-it përkatës në lidhje me verifikimin e statusit të tij. Nga ana e administratës po ju vihet në dispozicion dokumentacioni përkatës, si zotit {...} dhe zotit {...}.

Ndërkohë që përfaqësuesit e ILD-së njihen me aktin përkatës, do t'ia jepja fjalën relatorit, z. Hado, për të na prezantuar situatën aktuale në lidhje me statusin e zotit {...} në raport me paaftësinë e përkohshme të tij për punë.

Ridvan Hado: Në kushtet e mësipërme, kur subjekti {...}, në mënyrë permanente për një periudhë 6-mujore është me raport mjekësor dhe në kushtet kur rezulton se nga Drejtoria Rajonale Shkodër, Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor me shkresën nr. {...} regjistri, datë 12.06.2023 e ka dërguar në KEMP; gjithashtu nisur edhe nga e-maili i dërguar po nga subjekti {...} që rezulton që paraqitja në KEMP është ditën e sotme pas orës 12:30; marrë parasysh edhe faktin që në mbledhjet paraardhëse ne kemi vendosur referuar nenit 67, për të verifikuar mundësinë fizike dhe mendore të magjistratit; unë mendoj që seanca e sotme nuk mund të zhvillohet por duhet ta shtymë, të presim përfundimet e KEMP-it dhe propozoj, nëse janë dakord kolegët, ta shtyjmë për dy javë, në datë 5 korrik, që i bie ditë e mërkurë, ora 10:00. Nuk e di mendimin....

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Hado!

Përfaqësuesit e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, çfarë keni për të parashtruar në këtë situatë aktuale?

{...}: I qëndrojmë asaj që kemi mbajtur në të gjitha seancat e kaluara.

Ilir Rusi: Zoti {...}, fjala për ju!

{...}: Faleminderit zoti Nënkryetar!

Qëndrimi ynë si institucion është ai që kemi mbajtur edhe në seancat e kaluara, duam që ky procedim i nisur të jetë efektiv dhe ezaurues në varësi të rezultateve që do të dalin pasi të kryhet caktimi i një mbrojtësi/përfaqësuesi në bazë të Kodit të Procedurës Administrative dhe më pas vijimi me dokumentacionin/ shqyrtimin e atyre gjetjeve që ka ILD-ja. Megjithatë, ne i qëndrojmë në mënyrë respektuese pa diskutim vendimit që është marrë tashmë edhe për vlerësimin e gjendjes profesionale të magjistratit {...}. Por ajo që doja të vlerësoja dhe që është shumë e dobishme në drejtim të këtij procedimi disiplinor, që të kemi gjetje të sakta se si është gjendja e tij shëndetësore, shoh që në e-mailin që ai ka dërguar në drejtim të KLGJ-së na vë në dijeni se do ketë një takim ditën e sotme në datë 21.06., në orën 12:30 dhe për këtë arsye, në pamundësi objektive sepse do jetë përpara mjekëve, nuk mund të jetë në këtë seancë (në këtë procedim disiplinor). Por nuk shoh, nga aq sa verifikova, në fletën e drejtimit të KMCAP që mban datën 12.06.2023, me numër regjistri 8096, nuk shoh ndonjë datë konkrete për t'u bërë këqyrja e gjendjes së tij shëndetësore. Megjithatë e vlerësoj të dobishme që ky ekspertim duhet të përfundojë sepse është më se i rëndësishëm, që neve pastaj të shohim ecurinë e mëtejshme. Ju faleminderit nga ana juaj!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti {...}!

Zoti {...} keni diçka për të shtuar?

{...}: Jo, s'kam gjë për të shtuar.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Atëherë, për vijueshmërinë e këtij procesi, do t'ju ftoja të largoheshin pak, me qëllim që anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor të vazhdojnë me diskutimet dhe me vendimmarrjen përkatëse në lidhje me ecurinë e këtyre seancave dëgjimore në lidhje me tre procedimet disiplinore ndaj zotit {...}, për procedimin disiplinor nr. 3/2022, për procedimin disiplinor nr. 1/2023 dhe për procedimin disiplinor nr. 2/2023.

(Dalin nga salla e mbledhjes përfaqësuesit e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Gjithashtu shkëputet edhe lidhja me të tretët nga platforma “online”. Pas diskutimeve vetëm në prezencën e anëtarëve të Këshillit, rifuten në sallën e mbledhjes përfaqësuesit e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për t'u njohur me vendimmarrjen e Këshillit si dhe rilidhet lidhja me platformën “online”.)

Ilir Rusi: Prezent rishtazi përfaqësuesit e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, z. {...} dhe z. {...}.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, duke marrë në konsideratë aktet e paraqitura në raport me gjendjen shëndetësore të zotit {...}, parashtrimet e bëra edhe nga ana juaj në lidhje me veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor, konkretisht nga Komisioni përkatës i Zhvillimit të Karrierës, në lidhje me verifikimin e shëndetit të tij mendor por edhe gjendjes së tij fizike, vendosi që, seanca e radhës dëgjimore në lidhje me tre procedimet disiplinore, konkretisht nr. 3/2022, nr. 1/2023 dhe nr. 2/2023, të jenë në datën 19 korrik 2023, ora 10:00, ditë e mërkurë, në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, (ora 10:00, në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor.)

Faleminderit!

Ftoj përfaqësuesit e ILD-së të vazhdojnë me qëllim që Këshilli i Lartë Gjyqësor të procedojë me rendin e ditës, sipas kronologjisë.

(Dalin nga salla e mbledhjes përfaqësuesit e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.)

* * *

(Pikat 1, 2, 3 të rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

7

**Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 21.06.2023 (Pikat 1, 2, 3)**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.06.2023)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.12 datë 18.01.2023, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:16 dhe mbaroi në orën 12:21.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |

9. Yllka Rupa

(anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Fatmira Luli*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.

5. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.12, datë 18.01.2023, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Në vijim të rendit të ditës po vazhdojmë me pikën 4 të saj. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.12 datë 18.01.2023, për kandidaten znj. {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Njëkohësisht ju njoftoj që zonja {...} është njoftuar në lidhje me këtë procedurë, gjithashtu dhe ka konfirmuar marrjen e njoftimit nëpërmjet postës elektronike. Për më tej, fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Të nderuar kolegë!

Me vendimin nr.11- nr.24, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur hapja e katërmbëdhjetë vendeve (vakanca) për procedurë të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimet nr. 11 deri nr. 20, është vendosur hapja e procedurave për vendet vakante për lëvizjet paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile.

Në këto procedura, afati i kandidimit është përcaktuar dy javë nga dita e publikimit të vendimit përkatës në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Brenda afatit të kandidimit për pozicionet e lira nr.12, nr.17 dhe nr.20 datë 18.01.2023 kandidoi edhe znj. {...}, gjyqtare në Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër (aktualisht gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër).

Mbas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele dhe përcaktimit nga kandidatët të interesit për tre procedurat në proces, mbështetur në pikën 9, të vendimit nr.12/2023, nr.17/2023 dhe nr.20/2023 mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr.77, datë 13.02.2023, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose që mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë dhe znj. {...}.

Me vendimin nr. 115, datë 13.03.2023, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet e cituara më lart, Këshilli ka vendosur:

“I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Durrës.

II. Caktimin e relatorit ndër të tjera për secilin kandidat, si më poshtë: ... 12. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Alban Toro;...”.

Në përfundim të procedurës së verifikimit për kandidatin znj. {...} në lidhje me tre kriteret formale, konkretisht të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë

disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, të kandidimit të tij për lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira të përmendura më lart, Këshilli, me Vendimin nr. 185, datë 25.04.2023, ka vendosur:

1. Kualifikimin e kandidates {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 12, nr.17 dhe nr. 20, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ndërkohë, me vendim nr. 294, datë 30.05.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 136, në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjat “c” dhe “ë”, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 7, 8 dhe 9 të nenit 43, të Ligjit nr. 96/2016, si dhe në pikën 75, Kreu VI, të vendimit të tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve” Këshilli vendosi fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës për pozicionet e shpallura të lira, përkatësisht me vendimet nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20; 21 dhe 24, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Me këtë vendim, si relator i procedurës së përzgjedhjes për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 11, nr. 12, nr. 13 dhe nr. 17 u caktua kryetari i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Më datë 31.05.2023, në rrugë elektronike, në zbatim të pikës 75, Kreu VI, të vendimit të tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, kandidatja u njoftua për vendimin nr. 294, datë 30.05.2023 “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për lëvizje paralele, ku ajo kandidonte. Kandidatja nuk paraqiti kundërshtime ose kërkesa për përjashtimin e relatorit apo për ndonjë prej anëtarëve të tjerë.

Më datë 09.06.2023 nëpërmjet postës elektronike kandidatja, ka paraqitur kërkesën për tërheqjen nga kandidimi për procedurën e lëvizjes paralele për pozicionin e lirë nr. 12, datë 18.01.2023, në fushën e së drejtës civile, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, protokolluar në Këshill me aktin nr. {...} prot., datë 12.06.2023, duke parashtruar se: “...bazuar në vendimin nr.12, datë 18.01.2023 të

Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”, në datë 01.02.2023 kam shprehur interesin për lëvizje paralele pranë Gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë (sot Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë). Nëpërmjet kësaj kërkesë paraqes dorëheqjen time nga ky aplikim. ”. Pra kërkesa për dorëheqje është paraqitur në Këshill më datë 12.06.2023.

Në rrethanat sa sipër, përgatitet ky relacion bazuar në pikën 107, Seksioni “D”, Kreun VI të vendimit të Këshillit nr. 320, datë 17.09.2020 “Për kriteret dhe procedurën e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, ku përcaktohet se: “Në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për lëvizjen paralele janë të zbatueshme rregullat sipas pikave 54, 55, 59 dhe 60, të këtij vendimi.”; si dhe në pikën 108 Seksioni “DH” dhe në pikën 109 Seksioni “E”. Gjithashtu është mbajtur në konsideratë si dhe në pikën 59, Seksioni C, Kreun V, të vendimit nr.320/2020 ku përcaktohet se: “Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori përgatit relacionin ku përshkruhen shkurtimisht veprimet e kryera dhe projektvendimin mbi përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele për atë kandidat, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit.”

Shqyrtimi nga komisioni:

Duke vlerësuar të rregullt procedurën e verifikimit të ndjekur për znj. {...}, kandidate për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 12 datë 18.01.2023 si dhe duke pasur parasysh kërkesën e saj për t’u tërhequr nga kandidimi për këtë pozicion të lirë, relatori i çështjes ia parashtrroi rastin Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Në mbledhjen e datës 12.06.2023 Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke e konsideruar të rregullt procedurën e ndjekur për kandidaten znj. {...} si dhe po ashtu, duke vlerësuar të qartë dhe të plotë vullnetin e shfaqur nga kandidatja për t’u tërhequr nga kandidimi për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 12 datë 18.01.2023, i propozon Këshillit, bazuar në pikën 107, Seksioni D, Kreu VI, të vendimit nr. 320/2020, të vendosë dërgimin e çështjes

fillimisht në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për përfundimin e kësaj procedure për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi.

Bashkëlidhur relacionit përkatës kemi integruar edhe projektvendimin përkatës i cili përbëhet nga dy pika. Në pikën e parë të saj ne propozojmë të deklarohet përfundimi i procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.12, datë 18.01.2023, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

Një kopje e arsyetuar t'i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ftoj anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor nëse kanë diskutime për sa u përshtrua.

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.12 datë 18.01.2023, për kandidaten znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.12, datë 18.01.2023, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 4 të rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.06.2023)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.19, datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:16 dhe mbaroi në orën 12:21.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>5. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>8. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i> |

9. Yllka Rupa

(anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Fatmira Luli*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.

5. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.19, datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Ilir Rusi: Më tej vazhdojmë me pikën 5 të rendit të ditës. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.19, datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Më herët, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor është proceduar me hapjen e 14 procedurave të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë, përfshirë edhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ndërkohë që për pozicionin e lirë nr. 18, nr. 19, nr. 20, 18.01.2023 ka kandiduar edhe z. {...}, aktualisht gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Për zotin {...} janë bërë nga ana e Këshillit disa veprime procedurale të cilat synojnë verifikimin e kriterëve formale të kandidimit, ndër to mund të përmendim vendimin nr. 115, datë 13.03.2023, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr. 11 – nr. 24, datë 18.01.2023 me anë të së cilës ka filluar procedura e verifikimit për këtë kandidat.

Me vendimin nr. 188, datë 25.04.2023, nga ana e Këshillit është kualifikuar kandidati {...} dhe ka vijuar procedura e lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 18, nr.19 dhe nr. 20 datë 18.01.2023.

Ndërkohë që me datën 07.06.2023 nga ana e kandidatit {...} është paraqitur kërkesa për tërheqje nga kandidimi për procedurën e lëvizjes paralele, për pozicionin e lirë me nr. 19, datë 18.01.2023, në fushën e së drejtës civile në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Konkretisht, zoti {...} parashtron se ...“deklaroj se tërhiqem nga kandidimi im në procedurën e lëvizjes paralele në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 19 datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Duke qenë që tërheqja nga kandidimi është një nga parashikimet në aktin e Këshillit nr. 320/2020, nga ana e relatorit është përgatitur projektvendimi, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.19, datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Toro!

Ftoj anëtarët nëse kanë diskutime.

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Nuk dëgjohet

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.19, datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 19, datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si

dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 5 të rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.06.2023)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”/ “Për skualifikimin e kandidatit {...} nga procedura e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:16 dhe mbaroi në orën 12:21.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 2. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 3. Irena Plaku*** (anëtare)
- 4. Dritan Hallunaj*** (anëtar)

5. *Ridvan Hado* (anëtar)
6. *Alban Toro* (anëtar)
7. *Marçela Shehu* (anëtare)
8. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Fatmira Luli*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthtë.*
3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.*
5. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
6. *Edmond Hoxhaj, BIRN (hyn në platformë gjatë trajtimit të kësaj çështjeje).*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”/ “Për skualifikimin e kandidatit {...} nga procedura e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Më tej vazhdojmë me pikën 6 të rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”/ “Për skualifikimin e kandidatit {...} nga procedura e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Me disa vendime të datës 18.01.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor hapi katërmbëdhjetë procedura të lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimin nr. 20, procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe me vendimet nr.23 dhe nr. 24 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Në pozicionet nr. 20 dhe nr. 24 që i referohen lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe në Gjykatës e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ka kandidatë të kualifikuar me 2 (dy) vlerësime dhe procedura ka vijuar me caktimin e relatorit të përzgjedhjes për këto pozicione.

Në kushtet kur në pozicionin nr. 23 që i referohet Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, nuk ka kandidatë të kualifikuar me dy vlerësime, Këshilli me vendimin nr. 295, datë 30.05.2023 ka vendosur: Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallura me vendimet nr. 22 dhe nr. 23, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 1 (një) vlerësim.

Më datë 01.06.2023, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në vendimin e Këshillit nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të

gjqtarëve” (referuar vendimit nr. 320/2020), në rrugë elektronike, kandidati u njoftua: i) për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit; ii) për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; iii) për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit.

Brenda afatit të përcaktuar, kandidati nuk parashtrroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në vijim të procedurës së verifikimit, bazuar në pikën 55, Seksioni C, Kreu V, të vendimit 320/2020, përmes shkresave të veçanta, për kandidatin z. {...} u kërkuar dhe u administrua informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve personale dhe regjistrin të gjyqtarëve, si dhe nga gjykata ku kandidati ka ushtruar funksionin e gjyqtarit.

Për verifikimin e kritereve të “përvojës profesionale minimale specifike” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, më datë 01.06.2023 përcolli informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidatin z. {...}, siç do të përshkruhet më poshtë.

Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale specifike” të kandidatit në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë ku ai ka kandiduar, pra në fushën e së drejtës civile, referuar gjykatës ku kandidati ka ushtruar funksionin e gjyqtarit, informacioni u kërkuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Lezhë (– ish Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin). Nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Lezhë informacioni i kërkuar është përcjellë nëpërmjet postës elektronike më datë 06.06.2023, siç do të përshkruhet më poshtë.

Rezultatet e verifikimit:

Për kandidatin z. {...} u verifikua fillimisht kriteri i “Përvojës profesionale specifike minimale”.

“Përvoja profesionale specifike minimale” për lëvizjen paralele të gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë, në rastin konkret në Gjykatën e Shkallës së Parë të

Juridiksioni të Përgjithshëm Durrës, gjen pasqyrim në shkronjën “a”, pika 5, të vendimit 23/2023, ku është parashikuar në pikën 6, të nenit 43, të Ligjit për Statusin. Në këtë dispozitë parashikohet se: “Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se gjatë pesë viteve të fundit nuk ka të paktën një vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës për pozicionin e lirë ...”.

Për verifikimin e kandidatit në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për lëvizjen paralele u mbajt parasysh se ai ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin 23/2023, çka do të thotë se kandidati duhet të ketë të paktën një vit përvojë profesionale si gjyqtar në fushën e së drejtës civile gjatë pesë viteve të fundit para kandidimit.

Në lidhje me përvojën e profesionale, në kërkesën për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidati, është evidentuar se ai ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018 dhe ka ushtruar detyrën pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin deri më 06.03.2023, kur më pas është transferuar me pëlqim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Durrës, ku aktualisht ushtron edhe detyrën.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati z. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli “Jurist”, pranë Universitetit “Luarasi” në datë 03.07.2008 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018.

Me vendim nr. 133, datë 19.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është emëruar gjyqtar.

Me vendim nr. 146, datë 30.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Me vendim nr. 98, datë 06.03.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor transferohet përkohësisht pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe nga data 01.05.2023 ushtron funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 3 vite.

Zoti {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, nga verifikimet e kryera, rezultoi se: “Gjatë kohës që gjyqtari {...} ka ushtruar këtë funksion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin ka gjykuar çështje të natyrës civile dhe penale njëkohësisht. Kjo për faktin se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin për shkak të trupës së saj gjyqësore me numër të vogël nuk ka qenë e ndarë në dhoma apo seksione konkrete për gjykimin e çështjeve që vinin në këtë gjykatë. Për këtë arsye gjyqtarët që përbënin trupën gjyqësore të kësaj gjykate gjykonin çështje civile dhe penale sipas shortit elektronik.”

Nga dokumentacioni i përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, rezulton se vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit për kandidatin është 3 (tre) vite e 6 (gjashtë) muaj, pra më pak se 5 (pesë) vite. Është për t’u diskutuar aplikimi i pikës 6, të nenit 43, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se gjatë pesë viteve të fundit nuk ka të paktën një vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës për pozicionin e lirë”, nëse 5 (pesë) vitet e fundit të përmendura në këtë dispozitë, janë vite të ushtrimit të funksionit të gjyqtarit të kandidatis në lëvizje paralele.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 23, datë 18.01.2023, rezulton të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtar në fushën e së drejtës civile gjatë pesë viteve të fundit përpara kandidimit.

Për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

“Mospasja masë disiplinore në fuqi” është kriter ndalues që gjen pasqyrim në shkronjën “b”, pika 5, të vendimit nr.23/2023, i cili në vetvete është mbështetur në pikën 6, të nenit 43, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë nëse ka një masë disiplinore në fuqi.”

Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 01.02.2023, nëpërmjet të cilit,

përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ai ka deklaruar se: “Nuk kam masë disiplinore në fuqi”.

Sipas informacionit të përcjell nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, z. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, nuk vërtetohet që z. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi.

Për z. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”, si kriter i parashikuar në shkronjën “c”, të pikës 5, të vendimit 23/2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, vendim i cili është mbështetur në nenin 8, pika 2, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “Këshillat, gjatë ... transferimit, ..., për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë joproportionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, efënca e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë”. Ndërkohë, kuptimi i papajtueshmërisë ambientale përcaktohet në pikën 1, të kësaj dispozite ligjore, sipas të cilës: “Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë”.

Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, në rastin e aplikimit, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidati ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” datë 01.02.2023, nëpërmjet të cilit, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidati në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ai kandidon për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, për kandidatin z. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të transferimit

nëpërmjet lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Shqyrtimi paraprakisht nga Komisioni:

Duke vlerësuar të plotë procedurën e verifikimit paraprak për kandidatin z. {...} në lidhje me kriteret ligjore të kandidimit të tij për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023, relatori i çështjes ia parashtrori fillimisht këtë kërkesë Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Në mbledhjen e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, duke konsideruar të plotë procedurën e verifikimit për kriteret ligjore të kandidimit të z. {...} për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, bazuar në pikën 63, të Seksionit Ç, Kreu V, të vendimit 320/2020, si dhe në pikën 10, të vendimit 23/2023, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur për kualifikimin ose jo të kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023.

Bashkëlidhur relacionit ne kemi paraqitur projektvendimet përkatëse. Në këtë rast janë projektvendime përkatëse për shkak të diskutimit që ne kemi ngritur si çështje në lidhje me vjetërsinë prej 5 vjetësh, nëse janë 5 vjet të plota ose 5 vite gjyqtari ka 1 vit përvojë specifike në fushën e së drejtës përkatëse. Për këtë arsye ne kemi parashtruar projektvendimet në dy variante.

Në variantin e parë propozojmë kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së mëtejshme për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023. Ndërsa në variantin e dytë, ne propozojmë skualifikimin e kandidatit z. {...}, nga procedurat e lëvizjes paralele.

Këto janë propozimet tona dhe relacioni që i bashkëngjitet këtyre dy propozimeve. Për më tej do doja të jepja edhe mendimin tim personal në lidhje me këtë çështje. Sipas asaj që unë vlerësoj në lidhje me këtë çështje, referuar nenit 43 të ligjit “Për statusin”, pika 6 e tij, kam mendimin se në këtë rast afati 5-vjeçar është afati i plotë

ashtu sikundër është shkruar në këtë dispozitë. Kuptoj situatën, rrethanat, mbase edhe “nonsens-in” që mundet të diskutohet sot nëse duhet të jetë pesëvjeçari i plotë apo jo, por referuar ashtu sikundër është shkruar në pikën 6 të nenit 43, unë mendoj se që kandidati duhet të ketë një përvojë gjatë ushtrimit të funksionit të tij 5 vite të plota, brenda së cilës ai duhet të ketë 1 vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës për pozicionin e lirë që është shpallur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në rastin e procedurës së lëvizjes paralele. Kështu që, unë duke iu referuar asaj çfarë them më sipër, mendoj që zoti {...}, jo për shkak të cilësive të tij gjatë ushtrimit të funksionit, por vetëm për shkak të mosplotësisimit të përvojës prej 5 vjetësh, nuk plotëson një kriter ligjor për të vijuar më tej procedurën e kualifikimit të tij për të kandiduar, për të vijuar kandidimin e tij në pozicionin e lirë të shpallur në lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Ky ishte propozimi im dhe mendimi im në lidhje me situatën në të cilën ndodhet zoti {...}, por edhe kandidatë të tjerë në vijim, të cilët nuk plotësojnë sipas mendimit tim përvojën prej 5 vitesh si magjistrat.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Atëherë, meqenëse ka një kërkesë të të njëjtës kohë, të zonjës Plaku dhe zotit Toro, por meqenëse zoti Toro është anëtar i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, do t'i jepja fjalën zotit Toro.

Alban Toro: Tregon që jemi Komision dinamik dhe mund të ndajmë edhe opinione të ndryshme për çështjet e interpretimit të ligjit.

Në opinionin tim, pavarësisht se fillimisht kam qenë ashtu si kryetari, i mendimit që minimalisht magjistrati duhet të gëzonte një eksperiencë 5-vjeçare për të bërë një lëvizje paralele, por duke interpretuar më pas hyrjen në skemë të magjistratëve të tjerë të cilët kishin një vlerësim ose në mungesë të tyre asnjë vlerësim, konfirmon faktin që qëllimi i ligjvënësit ka qenë që thjesht ai magjistrat i cili konkurron në pozicion do duhet të kishte një eksperiencë minimale 1-vjeçare sa më të fundit dhe detyrimisht, në qoftë

se ky do të kishte një eksperiencë 5-vjeçare, brenda harkut kohor 5-vjeçar. Pra theksi sipas opinionit tim është vendosja e eksperiencës së fundit. Në qoftë se ai do të ketë një eksperiencë të fundit në atë fushë, detyrimisht ai do të ishte përfitues i atij pozicioni mbasi të bëhej edhe vlerësimi.

Kështu që, integrimi në skemë edhe i aktorëve të tjerë të cilët nuk kanë vlerësime, pra nuk kanë eksperiencë të madhe në punë mbi 5 vjet, por kanë eksperiencë e cila iu siguron edhe një vlerësim (dhe një vlerësim bëhet brenda periudhës 3-vjeçare) apo nuk kanë vlerësime fare, siç mund të ndodhi edhe në kandidatët që do të vijnë më pas ose mund të vijnë në të ardhmen, do të merrej për bazë vlerësimi që ka bërë shkolla. Kështu që në këtë pjesë, nëse ne do t'i përmbaheshim këtij opinionit, do të bllokoheshim dhe do të gjendeshim pa kandidatë, për të mundësuar plotësimin e vakancave. Ligjvënësi pikërisht ka parashikuar këtë mënyrë shfryrjeje/zhbllokuese, me qëllim që asnjëherë vakancat të mos jenë të gjata dhe të rrezikojnë “gjendjen shëndetësore” të sistemit.

Kështu që jam i opinionit që, në kundërshtim me kryetarin, opinionit im është që eksperiencia duhet të jetë e fundit dhe jo minimaliste 5-vjeçare.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Toro!

Ka diskutime nga anëtarët e tjerë?

Po, zonja Plaku!

Irena Plaku: Atëherë, unë jam dakord në fakt me sa parashtroi edhe zoti Toro. Mendoj se ligji duhet të interpretohet në tërësi/komplet neni 43, ku thuhet ndër të tjera që kush aplikon për lëvizje paralele, konkretisht magjistrati që ushtron funksionin në gjykatë ose në prokurori në të njëjtin nivel me pozicionin e lirë, magjistrati i komanduar që ka punuar më parë në gjykatë ose prokurori në të njëjtin nivel, dhe më pas kalohet tek dispozita tjetër ku thuhet që magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se gjatë viteve (nuk ka përdorur “nuk duhet”)... Po të shohim dhe termat që ka përdorur ligjvënësi, përdoret termi “gjatë” dhe nuk parashikohet që duhet të ketë së paku 5 vitet e fundit.

Në këtë rast mendoj që termi/përdorja e fjalës “gjatë”, do të thotë që shtrirja e përvojës profesionale duhet të jetë gjatë këtyre 5 viteve të fundit dhe jo ndalimi që duhet të ketë së paku 5 vjet, kjo rezulton edhe nga përmbajtja në tërësi e dispozitës përkatëse ku thuhet ndër të tjera që në procedurë në rast se nuk ka kandidatë me dy vlerësime, kalojmë më pas tek kandidatët që kanë 1 vlerësim, çka do të thotë që duhet të ketë minimalisht mbi tre vjet, por jo domosdoshmërisht 5, dhe më pas kalojmë tek vlerësimet që në rast se nuk ka asnjë kandidat me dy vlerësime apo me 1 vlerësim, kalohet tek renditja sipas Shkollës së Magjistraturës, çka do të thotë që minimalisht duhet të ketë 1 (një) vit përvojë profesionale që ai do kandidojë në lëvizjen paralele. Kjo vjen në lidhje edhe me parimin që Këshilli ka gjithë kohën detyrimin që brenda çdo tre muaj të shpallë lëvizjet paralele dhe më pas të propozojë për emërim për gjyqtar kandidatët për magjistratë. Çka do të thotë që në rast se nuk mbushen këto lëvizje paralele, këto vende vakante të shpallura për lëvizje paralele, me magjistratët që janë në detyrë, këto do shpallen si vende vakante kandidatëve magjistratë; çka do të thotë që ne do pranojmë më pas që të çojmë në këto lëvizje paralele magjistratë të cilët nuk kanë fare përvojë në punë dhe t’i refuzojmë ndër të tjera magjistratët që të paktën kanë 1 vit përvojë profesionale në punë.

Kështu që unë mendoj që vetë termi “gjatë” në radhë të parë e përcakton si shtrirje dhe jo ndalim.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Plaku!

Ka diskutime nga anëtarët?

Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Faleminderit zoti Rusi!

Në fakt unë këtë diskutim e kam bërë në një mbledhje tjetër të Këshillit, atëherë kur Këshilli vendosi që do ta marri në shqyrtim si diskutim kur të ishte një kandidat konkret që vihej në diskutim çështja edhe pse unë e hodha si parim në atë kohë. Qoftë nga ana e teknikës legjislativë të përdorur, ashtu edhe nga ana e qëllimit të dispozitës, vlerësoj që në këtë rast ligji nuk kërkon periudhë minimale profesionale të

detyrueshme për të aplikuar për lëvizje paralele. Pra nëse do të bëjmë krahasimin e dispozitës së lëvizjes paralele me dispozitën për ngritjen në detyrë, kanë formulime të ndryshme.

Tek ngritja në detyrë kërkohet përvoja minimale profesionale jo më pak se 7 vjet (thotë ligji “duhet të ketë jo më pak se 7), nga të cilat 5. Pra kërkon edhe përvojë minimale profesionale, kërkon edhe përvojë specifike.

Tek lëvizja paralele nuk e kërkon përvojën minimale profesionale në vlerësimin tim edhe pse mënyra sesi është formuluar dispozita, po ta lexosh, të krijon një konfuzion në fakt. Po ta lexosh të gjithën, arrin të kuptosh që përvojën minimale profesionale ligji ta ka detajuar në hapat që ti ndjek për të zhvilluar lëvizjen paralele, sepse duke hapur fillimisht lëvizjen paralele për gjyqtarët që kanë dy vlerësime, do të thotë që futen në këtë proces të gjithë gjyqtarët që kanë mbi 7 vjet ose mbi 6 vjet, duke marrë parasysh që ligji është konsideruar që të funksionojë në një situatë normale. Nëse nuk ka me këtë vjetërsi, pra nëse nuk ka gjyqtarë që kanë dy vlerësime, shkohet tek gjyqtarët që kanë një vlerësim. Kush janë gjyqtarët që kanë 1 vlerësim? Janë gjyqtarët që duhet të kenë mbi tre vjet, por më pak se gjashtë. Pra ky është grupi i gjyqtarëve me vjetërsi më të vogël që futen në hap të dytë në lëvizje paralele por këta gjyqtarë sigurisht do të futen vetëm nëse nuk do të ketë gjyqtarë me dy vlerësime. Në fund fare pastaj futen gjyqtarët që nuk kanë asnjë vlerësim, pra gjyqtarët që kanë më shumë se një vit dhe më pak se tre vjet, çka do të thotë që gjyqtarët me vjetërsi më të pakët ose më të ulët futen të tretët në radhë në procedurën e lëvizjes paralele.

Për këtë arsye mendoj që përvoja minimale profesionale nuk është kusht kandidimi. Kushti i kandidimit është vetëm përvoja specifike 1 vit. Veç kësaj, ligjvënësi ka parasysh edhe diçka tjetër, që këtë periudhë minimale profesionale ti të mos e kesh shtrirë pafundësisht por duhet ta kesh të shtrirë në pesë vitet e fundit, me qëllim sepse ligji ka për qëllim të nxisë specializimin.

Për këtë arsye unë vazhdoj t'i qëndroj të njëjtit arsyetim dhe të njëjtit propozim që kam bërë edhe herën tjetër, duke vlerësuar që mospasja e 5 viteve përvojë profesionale nuk është kusht pengues për skualifikimin e kandidatit, mjafton që ai të ketë 1 vit përvojë profesionale në fushën në të cilën janë hapur procedurat dhe këtë 1 vit ta ketë të shtrirë

në 5 vitet e fundit të karrierës. Kur e ka në 5 vjet, mund ta ketë edhe në 5 vitet e fundit, mund ta ketë edhe në 2 vitet e fundit, por gjithmonë duhet të ketë më shumë se 1 vit.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ukperaj!

Ka diskutime?

Po, zonja Shehu!

Marçela Shehu: Kolegët në fakt i thanë të gjithë argumentet. Unë doja thjesht të jepja mendimin tim. Ndaj edhe unë të njëjtin mendim që në lidhje me lëvizjen paralele, ajo që kërkon ligji është kriteri që përvoja minimale profesionale të jetë të paktën 1 vit, që përkon gjithashtu me përvojën specifike në fushën përkatëse që kërkon ligji për atë procedurë në lëvizjen paralele.

Bashkohem me kolegët që në këtë rast, qëllimi i ligjit është tek vënia e theksit që kjo përvojë profesionale specifike të mos jetë e shtrirë gjatë në kohë, do të jetë në 5 vitet e fundit për shkak të specializimit.

Përveç të gjithë argumenteve të tjera, do të referoja edhe nenin 172 të ligjit “Për statusin”, dispozitë tranzitore në fakt që rregullon caktimin e përkohshëm në pozicione të përkohshme të magjistratëve ku nuk ka vende të përhershme për caktimin e tyre. Po të lexosh në tërësi dispozitën i jep mundësi Këshillit që në rastet kur nuk ka vende të përhershme për caktimin e të gjithë magjistratëve, ata mund të caktohen në mënyrë të përkohshme në një vend të caktuar. Gjatë kësaj kohe, thotë ligji, atyre do t’u jepet mundësia që në procedurën e parë të lëvizjes paralele të hyjnë në garë.

Pra vetë ligji, ia lejon këtyre magjistratëve që janë caktuar në mënyrë të përkohshme, që i bie të jenë të sapoemëruar, që në momentin e parë që hapet një procedurë lëvizjeje paralele të hyjë në garë. Nëse ligji do të kishte një qëllim tjetër, pra që përvoja profesionale duhet të ishte 5 vjet, atëherë duhet të bënte një parashikim ndryshe, që këta magjistratë të caktuar në mënyrë të përkohshme nuk do të hynin në garë në një procedurë lëvizjeje paralele, por do të duhej që në momentin e parë që hapej një pozicion, të caktoheshe në mënyrë të përhershme.

Pra vetë ligji në të gjithë analizën ligjore logjike të tij, për të mos përsëritur të gjithë ato që thanë kolegët, ka parashikuar që në rastin e lëvizjeve paralele, minimumi i përvojës profesionale që duhet të kenë kandidatët duhet të jetë 1 vit, jo më shumë, por ky vit duhet të jetë në 5 vitet e fundit (të mos jetë para 10 vitesh).

Ky është edhe mendimi im që bashkohet me kolegët e tjerë. Faleminderit!

Ilir Rusi: Ka diskutime të tjera?

Po, zoti Kurushi!

Klodian Kurushi: Atëherë, të gjitha këto çfarë u diskutuan bashkërisht ne i kemi diskutuar në Komision dhe nuk janë çështje të reja, të paktën të panjohura nga ana jonë. E thashë edhe më përpara në atë pjesën e asaj çfarë unë doja ta parashtroja përpara Këshillit. Pa iu referuar rrethanave, pjesës së qëllimit, strukturës së organizuar të dispozitave, referuar thjesht pikës 6 të nenit 43, ligjvënësi kështu e ka shkruar atë dhe nga kolegët u mor për bazë edhe një metodë tjetër interpretimi që ishte ai gramatikor. Nëse ligjvënësi do të donte ta theksonte ashtu sikundër thanë kolegët, nuk kishte pse të thoshte “përgjatë 5 viteve të fundit”. Por ka një teknikë tjetër legjislative “deri në 5 vitet e fundit”, “gjër në 5 vitet e fundit”.

Jo, tani, njëlloj nuk është.

Siç janë afatet e sanksioneve të masave të dënimit “deri në 5 vjet burgim”, “deri 3 vjet burgim”, ashtu mund të donte ta plotësonte edhe këtë pjesë, por nuk e ka bërë (flasim si teknikë legjislative). Kjo neve na konfuzon. “Gjatë” është 5, apo “gjatë” është deri në 5? Po të ishte e thënë qartësisht “deri në 5”, do dakordësohesha dhe nuk do të kishim diskutime. Kjo është pjesa e parë. Dhe pastaj pse ka futur një vlerësim? E ka futur një vlerësim se 5 vjet kërkon. Dy vlerësime do minimumi 6 vite punë. Pra 5-ën, në 1 vit, ti ke mundësi t’i bësh edhe një vlerësim. Ai rasti përjashtimor është kur s’është bërë vlerësimi dhe do marrim dhe vlerësimin e Shkollës së Magjistraturës. E thashë, nuk i referohem rrethanave, kur është miratuar ky ligj kanë qenë të tjera rrethana, sot janë të tjera rrethana, dhe është e vërtetë që sot sistemi duhet mbushur. Kjo është një çështje praktike. Por mua nuk më “konvenjon” të them kjo çështje praktike dhe e nevojave që ka sot sistemi

duhet t'ia përshtatim këto nevoja ligjit. Ligji kështu është hartuar për pikën 6. Tjetër gjë se çfarë mendojmë ne dhe si duhet të ishte bërë më mirë që ne të mos kishim diskutime me njëri-tjetrin sot. Por ai është aty, e shkruar e zeza mbi të bardhë.

Tani, në lidhje me atë pikën tjetër që e shtroi për diskutim zonja Shehu, edhe atë e kemi diskutuar, por bëhet fjalë, sipas mendimit tim, për pozicionet e përkohshme dhe për pozicionet e përkohshme të magjistratëve që do caktohen në pozicion kur nuk ka pozicione të përhershme. Pra kur nuk kemi pozicione të përhershme, ekziston ajo dispozita tranzitore dhe janë për magjistratët që kanë mbaruar Shkollën e Magjistraturës. Kur nuk ka pozicione të përhershme, do shkojnë tek pozicionet e përkohshme, se nuk do t'i lëmë kur ka pozicione të përkohshme të lira, nuk do t'i lëmë magjistratët pa ushtruar funksionin e tyre. Është detyrim ligjor që na e thotë ajo dispozitë ligjore.

Në momentin e parë që do hapet vendi për një lëvizje paralele, absolutisht që magjistrati që nuk është sistemuar në një pozicion të përhershëm, do konkurrojë. Me çfarë lloj procedure do konkurrojë? Po me mekanizmin e lëvizjes paralele se s'ka mundësi tjetër si të konkurrojë. S'ka mundësi tjetër se si të sistemohet në pozicionin e lirë të përhershëm. Kështu që, kam përshtypjen që ai është një rast krejtësisht specifik dhe i referohet vetëm magjistratëve që kanë mbaruar trevjeçarin dhe që duhet të sistemohen, duhet të caktohen në pozicion dhe nëse nuk ka pozicione të përhershme, do shkojnë në të përkohshme derisa të hapet i përhershmi. Por është vetëm për magjistratin që ka mbaruar Shkollën e Magjistraturës.

Marçela Shehu: Po pra, Klodi të lutem, jam shumë dakord.

Ajo dispozitë është specifike dhe vetëm për ata që diplomohen, emërohen dhe për të cilët nuk ka vende të përhershme, ne i ofrojmë caktimin e përkohshëm sepse e kemi detyrim. Kjo nuk vihet në diskutim që vetëm për këtë kategori është. Unë vijova duke thënë që për këta kandidatë në momentin e parë që ka një pozicion të lirë të përhershëm ftohen të hyjnë në garë në procedurën e lëvizjes paralele. Po të kishte pasur tjetër qëllim ligji do thoshte, jo, ky vendi që është hapur shkon direkt ky gjyqtari në vendin që ka një vend të përkohshëm, që t'i sigurojmë një vend të përhershëm sepse e kemi detyrim. Por

nuk thotë këtë. Thotë fute në garë me të tjerët (fute me Marçelën, fute me Ridvanin, fute me të tjerët). Ky ka të drejtë të kandidojë.

Edhe diçka meqë e mora fjalën.

Klodian Kurushi: E thotë, edhe këtë pjesën e thotë.

Tek caktimet e përkohshme e thotë, me mandate të kufizuara. Nëse për atë vend që është i përkohshëm bëhet i përhershëm, ai shkon atje. Ndërsa kur hapet një pozicion tjetër atëherë ai ka të drejtë të kandidojë në lëvizjen paralele.

Ilir Rusi: Zonja Ukperaj!

Po, zonja Shehu, sepse ishe në vijueshmëri të arsyetimit.

Marçela Shehu: Meqë e kisha fjalën.

Unë kam atë mendim që parashtrova. Për mua logjika e ligjit ajo është.

Në lidhje me vlerësimet që thotë zoti Kurushi, për sa kohë ligji parashikon që në garë hyjnë ata që janë pa vlerësim, atëherë flitet pikërisht për këtë kategori, sepse ligji, mos harrojmë, është bërë për një kohë ideale. Ligji nuk është bërë për këto situatat tona tranzitore. Ligji është bërë për një situatë ku gjithçka funksionon normalisht: vlerësimet janë në kohë, të gjithë magjistratët kanë vlerësime. Cila është kategoria që s'ka vlerësime? Ata që sapo kanë mbaruar Shkollën. Kështu që për mua edhe ky moment është i tejkaluar.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Shehu!

Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Dispozita e referuar nga zonja Shehu dhe e analizuar prej saj është një ndryshim që bëri ligji “Për statusin” pikërisht për shkak të mungesës së vakancave që ne kishim në sistem dhe kjo ishte një dispozitë tranzitore e cila nuk mund të tejkalojë kohëzgjatjen e periudhës kalimtare, por pranoi që magjistratët të cilët caktoheshin në pozicione të përkohshme, pa dyshim që do futeshin në procedurat e

lëvizjeve paralele duke ndjekur ligji të njëjtën logjikë si neni 40 i ligjit “Për statusin”, i cili tashmë nuk është dispozitë tranzitore, është një dispozitë që e kemi ne dhe që bën fjalë se çfarë bëhet me gjyqtarët të cilët janë emëruar të tillë, kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës dhe janë caktuar në pozicione të komanduara. Neni 40 thotë - Caktimi i përkohshëm në pozicione të komanduara të të emëruarve – Në rastet kur magjistratët që mbarojnë shkollën emërohen gjyqtarë dhe nuk ka pozicione të lira, në një situatë normale tashmë e marrim ku ka mbaruar periudha kalimtare, ka mundësi, pas rivlerësimit, ka mundësi, dhe Këshilli ka detyrimin në qoftë se s’ka vende, t’i çojë në pozicione të komanduara (në Këshill, në Gjykatë të Lartë). Çfarë thotë për këta? “b) i emëruari i caktuar në një pozicion të komanduar në një institucion duhet të marrë (e ka detyruese) pjesë në procedurën e radhës të lëvizjes paralele në shkallën e parë, me qëllim që të caktohet sa më shpejt në një pozicion të lirë si magjistrat;...”. Pra edhe kjo dispozitë përforcon faktin që përvoja 5-vjeçare nuk është tek ne, sepse ne nuk mund të diskriminojmë dhe trajtojmë në mënyrë të ndryshme gjyqtarët të cilët kanë mbi 1 vit, por nuk kanë 5, nga magjistratët që ndoshta nuk kanë bërë akoma asnjë vit, por për t’u futur në një procedurë lëvizjeje paralele.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ukperaj!

Ka diskutime në vijim nga anëtarët?

Meqenëse nuk ka diskutime, duke marrë në konsideratë faktin që nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës janë paraqitur dy projektvendime, një për kualifikim dhe një për skualifikimin e zotit {...}, dhe në konsideratë të opinioneve të shprehura nga anëtarët, atëherë do të kalojmë në votimin e këtyre projektvendimeve ku secili anëtar të shprehet për kualifikimin apo skualifikimin në konsideratë të qëndrimit të vetë që ka sipas rastit.

Meqenëse aktet janë hartuar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe u relatuan nga kryetari i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, i cili pas parashtrimit dhe relatimit përkatës ka shprehur dhe një opinion në lidhje me rastin konkret, ftoj kryetarin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës për të na paraqitur në radhë kronologjike se cili prej projektvendimeve do të hedhim për votim të parin kualifikimin apo skualifikimin.

36

Klodian Kurushi: Zoti Rusi, atëherë unë ndjek radhën që ne kemi përcaktuar bashkëlidhur relacionit. Projektvendimi i parë është ai i kualifikimit të kandidatit z. {...} dhe projektvendimi i dytë është ai i skualifikimit të z. {...}. Kështu që të parin, nëse ma keni lënë mua si propozim, unë propozoj kualifikimin e z. {...}.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ftoj anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor të vazhdojnë me votimin e projektvendimit mbi kualifikimin e z. {...}.

Irena Plaku: Pro kualifikimit.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord për kualifikimin.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Kundër.

Ilir Rusi: Dakord me kualifikimin.

Atëherë, Vendim “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ndërkohë që projektvendimi për skualifikimin, meqenëse me 8 vota pro dhe 1 kundër u votua për kualifikimin e z. {...}, projektvendimi për skualifikimin nuk ka vend për t'u hedhur në votim.

* * *

(Pika 6 të rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.06.2023)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 22, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”/ “Për skualifikimin e kandidatës {...} nga procedura e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 22, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:16 dhe mbaroi në orën 12:21.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 2. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 3. Irena Plaku*** (anëtare)
- 4. Dritan Hallunaj*** (anëtar)

- | | |
|---------------------------|------------------|
| 5. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 6. <i>Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 8. <i>Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 9. <i>Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Fatmira Luli*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthtë.*
3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.*
5. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
6. *Edmond Hoxhaj, BIRN.*

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidates {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 22, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”/ “Për skualifikimin e kandidates {...} nga procedura e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 22, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë më tej me pikën 7 të rendit të ditës: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 22, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”/ “Për skualifikimin e kandidates znj. {...} nga procedura e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 22, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Fjala më tej për zotin Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Relacion “Për gjendjen e faktit dhe ligjit të zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre kriterëve ligjore të kandidimit për lëvizjen paralele të kandidates znj. {...}”.

Në pozicionin nr. 22, ndër të tjera, ka kandiduar edhe zonja {...} për vakancën e hapur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Në vijim të procedurës së verifikimit, bazuar në pikën 55, Seksioni C, Kreu V, të vendimit 320/2020, përmes shkresave të veçanta, për kandidaten znj. {...} u kërkua dhe u administrua informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve personale dhe regjistrin të gjyqtarëve.

Për verifikimin e kriterëve të “përvojës profesionale minimale” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, më datë 01.06.2023 përcolli informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për znj. {...}, siç do të përshkruhet më poshtë.

Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale specifike” të kandidates në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë ku ajo ka kandiduar,

referuar gjykatës ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtarit, informacioni u kërkuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Sarandë. Nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksioni të Përgjithshëm Sarandë informacioni i kërkuar është përcjellë me shkresën nr. {...} prot., datë 02.06.2023, siç do të përshkruhet më poshtë.

Për kandidaten znj. {...} u verifikua kriteri i “Përvojës profesionale specifike minimale”.

“Përvoja profesionale specifike minimale” për lëvizjen paralele të gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë, në rastin konkret në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Durrës, gjen pasqyrim në shkronjën “a”, pika 5, të vendimit 22/2023 të KLGJ-së si dhe në nenin 43, pika 6, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se gjatë pesë viteve të fundit nuk ka të paktën një vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës për pozicionin e lirë ...”.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli “Jurist”, pranë Universitetit të Tiranës në datë 13.07.2010 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018.

Me vendim nr. 136, datë 19.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtare.

Me vendim nr. 149, datë 30.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Me procesverbalin e Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, datë 03.11.2020 ajo zgjidhet Zëvendëskryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe nga data 01.05.2023 ushtron funksionin e Zv/Kryetares pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 3 vite.

Znj. {...} nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, nga verifikimet e kryera, pranë gjykatës ndodhen të administruara urdhrat me

shkrim ndër vite të kryetarit të gjykatës sa i përket formimit të trupave gjykues të gjyqtarëve prej vitit 2019. Sipas informacionit të ngarkesës vjetore të gjyqtarëve të përcjellë, për vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022, rezulton se znj. {...} ka gjykuar çështje penale dhe civile, konkretisht për vitin 2019 ka gjykuar 31 çështje themeli civile dhe 55 kërkesa civile; për vitin 2020 - 112 çështje themeli civile dhe kërkesa civile 27; për vitin 2021 ka gjykuar 169 çështje themeli civile dhe 153 kërkesa civile; dhe për vitin 2022 ka gjykuar çështje themeli 130 dhe kërkesa 121.

Nga dokumentacioni i përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, rezulton se vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit për kandidaten është 3 (tre) vite e 6 (gjashtë) muaj, pra më pak se 5 (pesë) vjet. Meqenëse relacionet janë bërë në të njëjtën kohë, është i njëjti konstatim është për t'u diskutuar aplikimi i pikës 6, të nenit 43, të Ligjit për Statusin, ku u diskutua dhe u vendos një standard.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 22, datë 18.01.2023, rezulton të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtare në fushën e së drejtës civile gjatë pesë viteve të fundit përpara kandidimit.

Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, nuk vërtetohet që kandidatja znj. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi.

Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”, fillimisht me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit për situatën e papajtueshmërisë ambientale të dorëzuar prej saj më datë 01.02.2023 përkundrejt përgjegjësisë ligjore, kandidatja ka deklaruar se: “Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidatja në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ajo kandidon për

lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit për kandidaten znj. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Fillimisht kjo çështje është shqyrtuar nga Komisioni i cili duke konsideruar të plotë procedurën e verifikimit për kriteret ligjore të kandidimit të znj. {...} për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, bazuar në pikën 63, të Seksionit Ç, Kreu V, të vendimit 320/2020, si dhe në pikën 10, të vendimit 22/2023, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur për kualifikimin ose jo të kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 22, datë 18.01.2023.

Bashkëlidhur relacionit ne kemi hartuar dy projektvendimet përkatëse. I pari i referohet rastit të kualifikimit të znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 22, datë 18.01.2023. Projektvendimi i dytë i referohet variantit të skualifikimit të kandidates znj. {...} në procedurat e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Për të vijuar më tej, duke qenë se Këshilli i Lartë Gjyqësor mbajti një qëndrim dhe një standard lidhur me rastin e diskutuar paraprakisht për zotin {...}, mendoj se ndodhemi në të njëjtat situata edhe për zonjën {...}, kështu që ndodhur në këto kushte, duke u bindur dhe duke respektuar vendimin e KLGJ-së, unë si relator tërheq propozimin për projektvendimin e dytë që i referohet variantit të skualifikimit të kandidates zonjës {...} nga procedura e lëvizjes paralele. Pra, propozoj, ashtu sikundër u mbajt qëndrim nga Këshilli, kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime nga anëtarët?

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin mbi projektvendimin për kualifikimin e kandidatës znj. {...}.

Irena Plaku: Pro kualifikimit.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 22, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 22, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 7 të rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.06.2023)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr. 503 dhe nr.504, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:16 dhe mbaroi në orën 12:21.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |

9. Yllka Rupa

(anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Fatmira Luli*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.

5. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

6. Edmond Hoxhaj, BIRN.

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr. 503 dhe nr.504, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Në vijim vazhdojmë me pikën 8 të rendit të ditës: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr. 503 dhe nr.504, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Në mbledhjen plenare të datës 21.11.2022, me vendimet nr. 502, nr. 503 dhe 504, datë 21.11.2022 Këshilli i Lartë Gjyqësor hapi procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit Tiranë, Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Korçë, (tashmë Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm) për pozicione të lira në fushën e të drejtës penale.

Afati i kandidimit për procedurën e ngritjes në detyrë sa më sipër u përcaktua deri më datë 05.12.2022.

Brenda afatit të kandidimit u paraqitën gjithsej 26 (njëzet e gjashtë) kandidatura, të cilët kanë kandiduar në procedurën e ngritjes në detyrë për pozicionet e lira në Gjykatën e Apelit Tiranë, Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Korçë, (tashmë Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm) në fushën e të drejtës penale.

Aktualisht, në procedurat e ngritjes në detyrë të shpallura me vendimet nr. 502, nr. 503 dhe 504, të vitit 2022, ka përfunduar procedura e verifikimit për disa nga kandidatët në këto pozicione, si më poshtë, Këshilli në këtë rast ka vendosur kualifikimin e tyre dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë, konkretisht kandidatët janë: {...}, për pozicionin nr. 502 dhe nr. 504; Për kandidatin z. {...}, për pozicionin e shpallur me vendimin nr.502; Për kandidaten znj. {...}, për pozicionin nr. 503 dhe nr. 504; Për kandidaten znj. {...}, për pozicionin nr. 504; Për kandidatin z. {...}, për pozicionin nr. 502; Për kandidatin z. {...} për pozicion nr. 502, Nr. 503 dhe nr. 504.

Sa më sipër, rezulton se në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 502, nr. 503 dhe 504, datë 21.11.2022, ka kandidatë të kualifikuar.

Në Vendimin nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, Kreun V, Seksioni A, titulluar “Fillimi i procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë dhe caktimi i relatorit”, pika 24, parashikohet se: “Këshilli, jo më vonë së 7 ditë nga vendimi i parë për kualifikimin e një kandidati, vendos fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë, si dhe cakton, nëpërmjet shortit, relatorin për atë procedurë.”.

Nga ana tjetër, në këtë akt nënligjor, pika 7, shkronja “j”, përcaktohet se: “Procedurë përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë”, nënkupton procesin administrativ të renditjes dhe përzgjedhjes, sipas rastit, kandidatin ose kandidatët e renditur më lart”. Më tej, në këtë akt nënligjor përcaktohet se: “Komision”, nënkupton Komisionin e Zhvillimit të Karrierës pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, që përbëhet nga tre anëtarë, anëtarët e përhershëm ose zëvendësues, duke ruajtur në çdo rast kompozimin e tij sipas pikës 10, neni 62, të Ligjit për Qeverisjen”. Në shkronjën “g”, të kësaj pike, përcaktohet se: “Relator”, nënkupton anëtarin e përhershëm ose zëvendësues të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, që zgjidhet me short për të realizuar një procedurë përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë”.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503 dhe nr.504, datë 21.11.2022”.

Propozimi i Komisionit

Nëpërmjet këtij projektvendimi, sipas pikës 1, Këshillit i propozohet të vendosë fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës penale të shpallur me vendimet e cituara më lart.

Po ashtu, sipas këtij projektvendimi, Këshilli do të duhet të caktojë relatorin për këtë procedurë përzgjedhjeje për emërim. Lidhur me këtë, Komisioni mban në vëmendje disa rrethana të veçanta: i) pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 502, nr. 503 dhe nr. 504 i përkasin një fushe të së drejtës që është ajo penale; ii) Këshilli ka nisur procedura të ngritjes në detyrë edhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë, Gjykatën Administrative si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në fushën civile, të cilat do të kenë edhe ato relatorin sipas fushave përkatëse; iii) qëndrimin e njëjtë të Këshillit, në vendimmarrjet e mëparshme, me qëllim administrimin sa më mirë dhe me efikasitet të këtij procesi, është propozuar që caktimi i relatorit të bëhet për secilën procedurë përzgjedhjeje për emërim sipas fushave të së drejtës të pozicioneve të lira të

shpallura me vendim të Këshillit. Pra propozohet një relator për tre pozicionet e lira në fushën e së drejtës penale.

Sa i përket relatorit për këtë procedurë përzgjedhjeje, bazuar në Vendimin e Këshillit nr. 70/2020, ai duhet të zgjidhet me short ndërmjet 3 anëtarëve të përhershëm të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës.

Projektvendimi i propozuar është i strukturuar në 2 pika.

Pika 1 e projektvendimit bën fjalë për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503 dhe nr.504, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Pika 2 e projektvendimit bën fjalë për caktimin e relatorit, pas zhvillimit të shortit, për këtë procedurë përzgjedhjeje për emërim.

Së fundi, në projektvendim parashikohet dhe momenti i hyrjes së tij në fuqi, konkretisht menjëherë me botimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ftoj anëtarët nëse kanë diskutime për sa u parashtrua deri tani nga relatori.

Meqenëse nuk ka diskutime, të vazhdohet nga administrata me përgatitjen e shortit sipas mekanizmit të relatuar nga relatori.

Procedura e shortit:

Futen në enën e qelqit shiritat e letrës me emrat e relatorëve: z. Alban Toro, z. Dritan Hallunaj dhe z. Klodian Kurushi.

Përzgjedhja nga shorti:

Përzgjidhet shiriti me emrin e zotit Klodian Kurushi.

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ftoj anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor nëse kanë diskutime apo jo.

(Nuk ka diskutime.)

Ilir Rusi: Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës, ku tashmë sipas shortit, relator do të jetë zoti Klodian Kurushi.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr. 503 dhe nr.504, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503 dhe nr.504, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e z. Klodian Kurushi, si relator të procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë, për pozicionet e shpallura me vendimet nr. 502, nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 8 të rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.06.2023)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për periudhën 2017-2019 (relatore znj. Irena Plaku).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:16 dhe mbaroi në orën 12:21.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Fatmira Luli*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.**
- 5. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
- 6. Edmond Hoxhaj, BIRN.**

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017-2019 (relatore znj. Irena Plaku).

Ilir Rusi: Më tej vazhdojmë me pikën 9 të rendit të ditës: Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017-2019, për të cilin është përgatitur relacioni përkatës, me relatore znj. Plaku. Për këtë pikë të rendit të ditës, sikundër ju vura re edhe në parashtrësën e pikës 4 të rendit të ditës, që zonja {...} është njoftuar për këtë procedurë dhe ka konfirmuar marrjen e njoftimit përkatës. Më tej fjala për relatoren znj. Plaku.

Irena Plaku: Faleminderit!

Atëherë po ju parashtroj në mënyrë të përmbledhur projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...} për vitet 2017-2019. Kjo e fundit është njoftuar rregullisht për projektraportin dhe raportin analitik, e cila nëpërmjet e-mailit ka konfirmuar marrjen dijëni si dhe më pas në datën 26.05.2023, ka paraqitur kundërshtimet

e saj lidhur me projektraportin për tre treguesit përkatës, të cilat do t' i relatoj më pas duke iu referuar treguesit përkatës që do relatohen nga ana ime.

Procedura e vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtaren ka filluar me vendimin nr. 371, datë 13.09.2022 të KLGJ-së. Janë administruar të gjitha dosjet dhe burimet e vlerësimit.

Shkurtimisht po kaloj tek kriteret e vlerësimit të gjyqtares.

Sa i përket kriterit të parë “Aftësia profesionale e gjyqtares”, konkretisht “Njohuritë ligjore”, “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave”, në projektraport janë parashtruar në mënyrë të detajuar të gjitha rrethanat që janë konstatuar nga burimet e vlerësimit. Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira për përshkrimin dhe analizën e fakteve, si të atyre me natyrë procedurale, në të cilat jepet një panoramë e qartë e ecures së çështjes dhe veprimeve të kryera, së bashku me analizën ligjore, në rastet kur elementët proceduralë lidhen në trajtimin e kërkesave të palëve, ashtu edhe të fakteve thelbësore të çështjes, të cilët paraqiten në mënyrë koncize, të plotë dhe analitike, duke integruar përgjithësisht provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Gjithashtu gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsytimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e saj.

Pas analizimit të këtij treguesi, vlerësohet se aftësia e saj është shumë e lartë duke e pikëzuar me 25 pikë.

Sa i përket treguesit “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, konkretisht nga burimet e vlerësimit është konstatuar se gjyqtarja referon dhe interpreton ligjin e zbatueshëm. Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit material dhe procedural në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter civil apo penal. Evidentohet një kujdesi i gjyqtares për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese,

praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ-së, si dhe për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor.

Sa më sipër, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është vlerësuar shumë e lartë, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Sa i përket “Qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit”, referuar burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtarja gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet gjyqësore, është e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

Në përdorimin e instituteve të së drejtës apo parimeve të përgjithshme të së drejtës procedurale dhe materiale, evidentohet përdorimi i termave/shprehjeve në gjuhën latine, përgjithësisht duke u shoqëruar në thonjëza, dhe duke i dhënë interpretimin përkatës të tyre. Në referimin e fjalëve me karakter teknik, kryesisht në referimin e konkluzioneve të akteve të ekspertimit apo në kuadër të referimit të ligjeve të posaçme, përdorimi i termave teknikë është i kufizuar, i shoqëruar me shpjegimin e tij ose kuptohet qartë nga konteksti i arsyetimit.

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve apo shprehjeve që mund cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues. Në vendimet gjyqësore për çështjet familjare (me objekt zgjidhje martesë), evidentohet kujdesi i gjyqtarës për zgjedhjen e gjuhës së përdorur, pavarësisht mënyrës së formulimit të tyre nga palët.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i rregullave gramatikore, të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes, apo shprehjes së mendimit juridik. Në të gjitha vendimet gjyqësore rezulton përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip.

Lidhur me këtë kriter aftësinë e saj e kam vlerësuar shumë të lartë.

Në konkluzion, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja i kushton rëndësi të posaçme arsyetimit të vendimeve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë për lexuesin. E njëjta rëndësi evidentohet edhe në drejtim të

koncizitetit të pjesës përshkruese, në çdo nënndarje të saj, duke i dhënë peshën e nevojshme në arsyetim çdo pjese të vendimit, sipas përmbajtjes.

Pas analizimit të të dhënave lidhur me këtë tregues është vlerësuar se aftësia e saj është shumë e lartë duke e pikëzuar me 15 pikë.

Sa i përket treguesit “Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit”, në projektraport është analizuar secila pjesë e vendimit, çfarë janë konstatuar në secilën pjesë të saj, me të cilën ju jeni njohur.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi të larta në ndjekjen e një strukture të organizuar të vendimit, të ndarë në tituj dhe gjithmonë mendimi është ndarë në paragrafë. Gjyqtarja ndjek përgjithësisht një strukturë sipas këtij rendi: trajtimi i aspekteve procedurale të ngritura gjatë gjykimit apo të vlerësuara kryesisht nga gjykata, parashtrimi i rrethanave të faktit, pretendimet e palëve ndërgjyqëse, të cilat janë përgjithësisht pjesë e rrethanave të faktit, ligjin e zbatueshëm, trajtimi i çështjeve që duhet të shqyrtohen nga gjykata në lidhje me themelin, duke përfshirë analizën e pretendimeve të palëve dhe në fund të pjesës arsyetuese ose të çdo pjesë të veçantë të tij, përfundimet e arritura nga gjykata. Konstatohet që për çdo nënndarje apo njësi e vendimit të jenë vendosur titujt përkatës dhe fjali tematike, për orientimin e duhur të palëve dhe gjykatave më të larta mbi përmbajtjen e vendimit si dhe në shërbim të qartësisë dhe kuptueshmërisë së tij duke mundësuar përgjithësisht lexim të organizuar dhe të strukturuar në rrjedhë logjike. Por nuk konstatohet e njëjta qartësi në pjesën e parë të vendimit, konkretisht me paraqitjen e saktë të palëve pjesëmarrëse në gjykim dhe tek pjesa e fundit në përcaktimin e saktë të shpenzimeve gjyqësore. Pasi në disa vendime, mungon pasqyrimi i plotë i palëve pjesëmarrëse në gjykim, i cili është tepër e domosdoshëm pasi lidhet drejtpërdrejtë me qartësinë e vendimit si për sekretarinë gjyqësore, e cila do të bëjë njoftimet e vendimit palëve pjesëmarrëse, e më pas me të drejtën e ankimit si dhe orientimin e gjykatave më të larta lidhur përmbajtjen e vendimit në shërbim të qartësisë dhe kuptueshmërisë.

Pas analizimit të të dhënave lidhur me këtë tregues është vlerësuar aftësia e saj mbi mesatare duke e pikëzuar me 8 pikë.

“Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik”, në tërësi referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, duke i vlerësuar tërësinë e tyre në raport me natyrën e çështjeve, komplekse ose jo, rezulton se gjyqtarja ka aftësi mbi mesatare në lidhje me këtë tregues. Konstatohet së vendimet gjyqësore burim vlerësimi, në varësit të kompleksitetit të çështjes dhe pretendimet e palëve, në pjesën analitike të tyre përmbajnë argumenta të lidhura me njëri-tjetrin, duke i ndalur shkurtimisht tek evidentimi i lidhjes shkak-pasojë në raport me konkluzionet për zgjidhjen e çështjes. Përgjithësisht gjyqtarja i kushton rëndësi analizimit të pretendimeve të palëve në raport me ligjin që gjen zbatim si dhe me rrethanat konkrete të çështjes, duke i dhënë përgjigje të argumentuar si për çështjet e procedurës ashtu dhe ato për themelin e çështjes. Megjithatë, referuar burimeve të vlerësimit nuk evidentohet e njëjta shkallë kujdesi në drejtim të analizës dhe argumentit logjik, si në raport me rrethanat e faktit ashtu edhe në raport me pasqyrimin e pretendimeve dhe analizimin e tyre, pasi elementi analitik në pjesën më të madhe të vendimit dominohet nga analiza abstrakte e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, duke u pasuruar me qëndrimet e praktikës gjyqësore dhe integrimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, dhe një pjesë me e vogël në përshkrimin dhe analiza e fakteve të çështjes. Përgjithësisht, arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve apo çështjeve të shtruara për diskutim në aspektin procedural dhe thelbësor, me qëllim dhënien e një përgjigjeje të argumentuar në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes, por nuk konstatohet e njëjta analizë tek çështjet komplekse, të cilat në fakt evidentojnë më qartë shkallën e analizës dhe argumentit logjik të gjyqtarit.

Sa më sipër, lidhur me këtë tregues, është vlerësuar se aftësia e saj është “Mbi mesatare” duke e vlerësuar me 20 pikë.

Lidhur me këtë tregues gjyqtarja ka paraqitur kundërshtime duke kërkuar pikëzimin e saj maksimal. Konkretisht, thotë: “*Vlerësoj të sqaroj se rezulton të jetë një kërkim i palës paditëse në detyrimin e palës së paditur për lirimin e dorëzimit të pasurisë objekt gjykimi*”. Në fakt, tek analiza e projektraportit janë pasqyruar edhe çështjet kur janë evidentuar këto mangësi. Gjyqtarja ka kundërshtuar si më poshtë: “*Nisur nga natyra e mosmarrëveshjes, pasi kam identifikuar thelbin e saj dhe ligjin e zbatueshëm, jam*

ndalur në analizën e padisë së rivendikimit, duke identifikuar kushtet që duhet të plotësohen në referim të dispozitës konkrete ligjore, për të vijuar me verifikimin e këtyre kushteve në raport me rrethanat e provuara. Konkretisht kam sqaruar në themelin e padisë së rivendikimit qëndron verifikimi i kushteve: së pari, objekti i kërimit; së dyti, paditësi është pronar i sendit; së treti, i padituri nuk ka asnjë të drejtë mbi sendin në pronësi; etj. Mbi këtë bazë, është vijuar me analizën e rrethanave të vërtetuara në gjykim, prej të cilave është konkluduar se pala paditëse nuk ka provuar kushtin e dytë atë të qenies pronar. Po kështu, është konkluduar se nuk provohet as kushti i treti,...”. Në fakt këtu ka analizuar edhe një herë vendimin gjyqësor.

“Sa më sipër, mendoj se kam trajtuar në mënyrë rigorozë pretendimet dhe prapësimet e palëve, duke iu dhënë përgjigje, si në pjesën arsyetuese, ashtu edhe në pjesën urdhëruese të vendimit. Gjithashtu, mendoj se në kushtet kur padia është çmuar si e pabazuar duke argumentuar shkaqet përkatëse, trajtimi i të gjithë pretendimeve, edhe nëse do të kishte ndonjë tjetër që lidhej me kërkimin, do të ishte irrilevante”.

Gjithashtu ka marrë në analizë edhe projektraportin.

“Në projektraport është konkluduar se: “...elementi analitik në pjesën më të madhe të vendimit dominohet nga analiza abstrakte e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, duke u pasuruar me qëndrimet e praktikës.”

Në fakt është konstatuar se gjyqtarja identifikon qartë ligjin e zbatueshëm dhe bën një analizë abstrakte të dispozitave përkatëse, pjesë kjo që është vlerësuar tek interpretimi i ligjit sepse analiza abstrakte lidhet tek treguesi “Interpretimi i ligjit të zbatueshëm”.

“Në vlerësimin tim, një konkluzion i tillë nuk qëndron pasi në çdo vendim gjyqësor qoftë civil apo penal pjesa e parë i është dedikuar evidentimit të fakteve të provuara gjatë gjyqimit dhe provave në të cilat këto fakte mbështeten. Më pas, në pjesën e “vlerësimit të gjykatës” apo “arsyetimit ligjor”, pasi janë analizuar institutet përkatëse dhe parashikimet ligjore, është verifikuar raporti me faktin konkret. Kështu, në të gjitha vendimet gjyqësore, përfshirë edhe ato me natyrë më komplekse, zhvillohet koncepti apo instituti i së drejtës mbi të cilin themelohen pretendimet dhe prapësimet e palëve, për të verifikuar më pas zbatimin e tyre në rrethanat konkrete, duke evidentuar në këtë mënyrë edhe marrëdhënien shkak-pasojë. Gjithashtu, të gjitha vendimet gjyqësore kanë

përmbajtje gjithëpërfshirëse, duke marrë në analizë dhe duke u dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve apo prapësimeve të palëve, edhe në raport me vendimet unifikuese apo vendimet e Gjykatës Kushtetuese, kur është rasti. Mbi këtë bazë, vlerësoj se niveli i arsytimit në të gjitha vendimet gjyqësore të periudhës së vlerësimit përmbush më së miri standardin e kërkuar e si rrjedhojë mendoj se duhet të vlerësohem maksimalisht në lidhje me këtë tregues.” – është pretendimi i gjyqtarës.

Propozimi për kriterin e parë është 93 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

“Aftësia organizative e gjyqtarës”, “Respektimi i afateve ligjore”.

Në tërësi, pas analizimit të burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore. Nëse në përlllogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor, përjashtohen çështjet ku afati ligjor është tejkaluar me një kohë relativisht të shkurtër (deri në 2 ditë) si dhe zbritet koha gjatë se cilës gjyqtarja ka kryer lejen vjetore dhe kohën kur ajo ka qenë në pamundësisë për t’u paraqitur në punë për arsye shëndetësore (të provuara me raport shëndetësore), atëherë numri i çështjeve të përfunduara jashtë afatit do të rezultonte 27 çështje dhe për pasojë, raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkallim të afatit ligjor (27 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (296 çështje), rezulton të jetë 9.1 % të çështjeve të përfunduara tej afatit ligjor, përqindje që sipas Metodologjisë vlerësohet me 15 pikë.

Për sa më sipër është propozuar pikëzimi i saj me 15 pikë.

Sa i përket treguesit “Plotësimi i standardeve minimale”, janë analizuar çështjet referuar edhe raportit analitik, ku janë zbritur edhe disa çështje. Pasi është bërë një analizë e këtyre çështjeve, të dhënave statistikore, rezulton se gjithsej janë 37 çështje që do të llogariten të gjykuara brenda standardit minimal kohor dhe do t’i zbriten numrit prej 116 çështjesh të përlllogaritura në raportin analitik, duke mbetur kështu 79 çështje.

Duke konsideruar sa më sipër, numri total i çështjeve për të cilat parashikohet standardi minimal kohor është 806 dhe numrit total të çështjeve të përfunduara jashtë standardit minimal kohore cila nuk është më 116, por rezulton të jetë 79 çështje, ose 9.8% e numrit total të çështjeve.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, nëse në përlogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë standardit minimal kohor, përjashtohen çështjet ku standardi është tejkaluar me një kohë relativisht të shkurtër (deri në 7 ditë), atëherë numri i çështjeve të përfunduara jashtë afatit do të rezultonte 79 çështje dhe për pasojë, raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkallim të standardit minimal, me numrin total të çështjeve të gjykuara, rezulton të jetë 9.8%, përqindje e cila sipas metodologjisë së pikëzimit pikëzohet me 5 pikë.

Sa më sipër është propozuar pikëzimi i saj për këtë tregues me 5 pikë.

Për sa i përket “Kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje”, janë analizuar të gjitha në projektraport kategoritë e çështjeve dhe si janë gjykuar këto.

Në metodologjinë e pikëzimit parashikohet se për të bërë pikëzimin e këtij treguesi, të dhënat statistikore analizohen sipas situatës për të shmangur përfundimet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Referuar metodologjisë, duke qenë se për të gjitha kategoritë e çështjeve, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e shkurtër se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, gjyqtarja duhet të pikëzohet në nivelin maksimal për këtë tregues.

Sa më sipër propozohet pikëzimi i saj me 5 pikë.

Sa i përket “Rendimentit të përfundimit të çështjeve”, referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, për të gjithë periudhën e vlerësimit (01.01.2017-31.12.2019) si raport midis numrit të çështjeve të përfunduara (1103 çështje) me numrin e çështjeve të caktuara (1292 çështje) brenda periudhës 3-vjeçare të vlerësimit, është 85.37 % përqindje e cila sipas metodologjisë pikëzohet me 4 pikë. Është bërë një ndarje e rendimentit në secilin vit.

Për vitin 2017 rendimenti ka rezultuar 86 %;

Për vitin 2018 rendimenti ka rezultuar 85.4 %;

Për vitin 2019 ka rezultuar 84 %.

Janë marrë në analizë të dhënat statistikore dhe shkaqet të cilat kanë çuar në këtë rendiment.

Referuar treguesit sasior, rezultoi se gjyqtarja ka përfunduar në periudhën 3-vjeçare të vlerësimit në total 1103 çështje nga të cilat 695 çështje me palë kundërshtare. Referuar standardit sasior në fuqi, gjyqtarja duhet të përfundonte jo më pak se 200 çështje me palë kundërshtare në vit, pra 600 çështje në tre vjet. Gjyqtarja e ka kaluar standardin minimal sasior me 95 çështje, apo me 15.8%.

Ka rezultuar se gjyqtarja për një periudhë të caktuar kohe ka qenë me raport shëndetësor dhe janë përshkruar periudhat që gjyqtarja ka qenë me raport shëndetësor. Konkretisht ka qenë rreth 1.5 muaj në vitin 2018 dhe për rreth 4 muaj në fund të vitit 2019 dhe vitit 2020. Pra gjyqtarja ka gjykuar gjithsej 695 çështje me palë kundërshtare për një periudhë gati 2 vjet e gjysmë, pra mesatarisht 278 çështje me palë kundërshtare në vit, duke e tejkaluar kështu standardin minimal sasior në një vit me 78 çështje, apo 39 %. Pra përqindja 39 që ka gjykuar mbi standard është llogaritur pasi është zbritur edhe periudha që gjyqtarja ka qenë me raport shëndetësor. Pra është marrë në konsideratë kjo rrethanë e tillë.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, megjithëse rendimenti i gjyqtarës për periudhën e vlerësimit është 85.37 %, përqindje e cila referuar metodologjisë së pikëzimit pikëzohet me 4 pikë, pasur parasysh faktin se gjyqtarja gjatë vitit 2018 dhe gjatë vitit 2019 ka qenë në periudha të gjata kohore me raport shëndetësor, faktin se në çdo vit ajo e ka tejkaluar standardin minimal të ngarkesës në punë, mesatarisht me rreth 78 çështje në vit, apo 39 %, (kjo përqindje është llogaritur pasi është zbritur periudha që gjyqtarja ka qenë me raport shëndetësor), është vlerësuar që të rritet me një nivel pasur parasysh këtë rrethanë. Por nuk mund të arrihet në një nivel tjetër, pasi nuk rezulton që gjyqtarja gjatë gjithë periudhës së vlerësimit të ketë tejkaluar standardin sasior me mbi 50 % siç parashikon metodologjia.

Për këtë arsye është vlerësuar duke e rritur me një nivel, me 6 pikë.

Siç e thashë, gjyqtarja ka paraqitur kundërshtime lidhur me këtë tregues, duke kërkuar vlerësimin e saj me 8 pikë, ku ndër të tjera në kundërshtimet e saj ka parashtruar faktin që ka qenë me raport shëndetësor, rrethanë e cila është marrë parasysh në projektraport; si dhe ka paraqitur edhe kundërshtimin se ka tejkaluar standardin minimal me 78 çështje më tepër ose 39% (siç është relatuar në fakt në projektraport). Por duke

qenë se unë vlerësoj se pasur parasysh dhe standardet ose praktikën që kemi ndjekur, duke qenë se nuk është tejkaluar standardi minimal me mbi 50% mbi mesataren dhe të cilat mund të çojnë në një pikëzim tjetër dhe duke qenë se janë marrë parasysh në arritjen e kësaj përqindjeje 39% të tejkalimit të standardit minimal, është llogaritur vetëm pasi është zbritur periudha e cila kjo e fundit ka qenë me raport shëndetësor, pasi në rast se nuk do zbritej kjo periudhë rendimenti... më fal, përqindje e cila është tejkaluar, ka rezultuar me 15%. Sa më sipër, unë i qëndroj propozimit me 6 pikë lidhur me këtë tregues.

“Koha mesatare e arsyetimit të vendimit”, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit ka rezultuar se ka tejkaluar në një nënkategori.

Domethënë nga burimet e vlerësimit ka rezultuar se koha mesatare e arsyetimit të vendimit konkretisht koha mesatare ka tejkaluar në dy nënkategori. Sa më sipër, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, referuar metodologjisë së vlerësimit ky tregues pikëzohet me 12 pikë. Megjithatë, duke marrë parasysh rrethanat e tjera, në rastin konkret lidhur me këtë tregues, duke marrë në konsideratë volumin e çështjeve ku rezultoi se për një periudhë trevjeçare (2017-2019), gjyqtarja ka dhënë 1103 vendime, si dhe angazhimet e gjyqtarës, gjykimet e tjera si anëtare e trupit gjykues apo kur është e deleguar si gjyqtare në Mat, është propozuar që për këtë tregues gjyqtarja të pikëzohet me një nivel më të lart se ai i përcaktuar në metodologji, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Sa më sipër për këtë tregues propozohet pikëzimi i saj me 15 pikë.

“Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore” – bazuar në sa është parashtruar në projektraport, ka rezultuar se numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve me palë kundërshtarë të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 2,25 seanca dhe në çdo rast gjyqtarja ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave joproduktive, për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave, shkalla e aftësisë duhet të vlerësohet në nivel maksimal, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Sa i përket treguesit “Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor”, në tërësi referuar të dhënave të pasqyruara në

raportin analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse.

Sa më sipër, lidhur me këtë tregues është vlerësuar aftësia e saj “shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

“Aftësia e gjyqtarës për të administruar dosjen gjyqësore”, konkretisht “Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” - në tërësi rezulton se renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin logjik (sipas kategorisë) dhe kronologjike (brenda së njëjtës kategori aktesh), është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

Bazuar në sa më sipër, vlerësoj se aftësia e saj është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 5 pikë.

Sa i përket treguesit “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes”, nga burimet e vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se në dosjet e përzgjedhura me short, është përfshirë vetëm dokumentacioni që i ka shërbyer zhvillimit të procesit gjyqësor konkret, duke filluar nga momenti i shortimit deri në dhënien e vendimit (*njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seance përgatitore apo gjyqësore, vendimet për caktimin e seancave gjyqësore, vendimet e ndërmjetme të arsyetuara, vendimet gjyqësore*) si dhe aktet e paraqitura nga palët (*kërkesë padia, provat dhe diskutimet përfundimtare*).

Në dosjet penale nuk rezulton të jetë administruara kopje e “Letrës së të drejtave”, e cila i bashkëlidhet njoftimit për të pandehurin, personit nën hetim apo të dëmtuarit nga vepra penale, ndërkohë që komunikimi me shkrim i saj, bashkëlidhur njoftimit për seancën gjyqësore, parashikohet në mënyrë të shprehur në nenet 34/a, 58, 140 paragrafi 1 dhe 137 i K.Pr.Penale. Pavarësisht se të drejtat e parashikuara nga këto nene subjekteve i janë garantuar, duke iu bërë me dije edhe gjatë zhvillimit të gjykimit, mosadministrimi i kopjes me shkrim të këtij akti, bashkëlidhur kopjes së njoftimit që

administrohet në dosjen gjyqësore, përbën një të dhënë që duhet vlerësuar në drejtim të plotësisë së dokumentacionit.

Referuar sa më sipër vlerësoj se aftësia e gjyqtares për këtë tregues është “mbi mesatare”, pasi në dosjet e vëzhguara nuk rezulton prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete apo mungesa të akteve të që lidhen me çështjen konkrete, përveç mungesës të "Letrës të të drejtave” e cila nuk rezulton të jetë administruar bashkëlidhur kopjes së njoftimeve për seancën e parë gjyqësore për të pandehurin dhe të dëmtuarin nga vepra penale në dosjet penale të përzgjedhura me short.

Sa më sipër është vlerësuar pikëzimi i saj me 8 pikë.

Edhe për këtë tregues gjyqtarja ka paraqitur kundërshtime duke pretenduar se i është njoftuar “Letra e të drejtave” bashkëlidhur njoftimeve dhe është praktikë jo vetëm e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, por në të gjitha gjykatat e Republikës së Shqipërisë, që një kopje i bashkëngjitet njoftimit, por nuk kthehet me postë.

Në fakt, për të verifikuar këtë rrethanë, janë parë të gjitha njoftimet dhe siç njoftimet kanë rregullisht që i bashkëngjitet njoftimit “Letra e të drejtave” apo kërkesë padia, nuk ka një shënim të tillë që ne të provojmë faktin që është dërguar apo jo.

Sa më sipër, është propozuar pikëzimi i saj me 8 pikë.

Propozimi për nivelin e përgjithshëm për sa i përket kriterit të “Aftësive organizative” është 94 pikë, "Shkëlqyeshëm".

Për sa i përket “Etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale”, “Etika në punë”, rezulton se nuk ka të dhëna të cilat mund të afektojnë këtë tregues. Për sa më sipër është vlerësuar pikëzimi i saj me 35 pikë.

Sa i përket “Integritetit” të gjyqtares edhe për këtë tregues nuk ka të dhëna. Sa më sipër është vlerësuar aftësia e saj shumë e lartë, duke e pikëzuar me 40 pikë.

Sa i përket treguesit “Paanësia” e gjyqtarit, në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë. Për sa më sipër është vlerësuar aftësia e saj shumë e lartë, duke e pikëzuar me 10 pikë.

“Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar” – referuar burimeve të vlerësimit pasqyruar në raportin analitik, rezulton se për periudhën e vlerësimit janë paraqitur 6

kërkesa për përjashtimin e subjektit, të cilat janë rrëzuar. Ndërkohë, rezulton se vetë subjekti i vlerësimit ka paraqitur 24 kërkesa për heqje dorë, nga të cilat 22 janë pranuar.

Sa më sipër, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës duhet të konsiderohet “I pakonsiderueshëm”, duke e vlerësuar me 15 pikë.

Kështu propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” është 100 pikë, “Shkëlqyeshëm”.

“Aftësia personale dhe angazhimi profesional”, konkretisht treguesi “Komunikimi i qartë dhe transparent”, rezulton se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent, sa më sipër aftësia e saj është vlerësuar shumë e lartë, duke e pikëzuar me 15 pikë. (*lapsus, pasi gjyqtarja është vlerësuar 25 pikë për këtë tregues, ndërsa treguesi tjetër “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është vlerësuar me 15 pikë.*)

“Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët” – nga burimet e vlerësimit nuk ka të dhëna që mund të ndikojnë për këtë tregues. Për sa më sipër është vlerësuar se aftësia e saj për këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 15 pikë.

E njëjta gjë vlen edhe për sa i përket treguesit “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore”, për të cilën është vlerësuar pikëzimi i saj me 10 pikë.

“Gatishmëria e gjyqtarës për t’u angazhuar në veprimtari të tjera” – konkretisht ka rezultuar se gjyqtarja ka marrë pjesë në trajnimin vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në 22 aktivitete trajnuese të zhvilluar gjatë periudhës së vlerësimit, gjithsej 40 ditë trajnime. Gjithashtu ka marrë pjesë në një trajnimin jashtë Shkollës së Magjistraturës. Referuar sa më sipër, duke qenë se është brenda treguesit 15-120 ditë është vlerësuar pikëzimi i saj me 20 pikë.

“Disponueshmëria e gjyqtarës për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë”- Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja nuk është angazhuar në aktivitete trajnuese si lehtësuese apo eksperte pranë Shkollës së Magjistraturës.

Sa më sipër është propozuar pikëzimi i saj me 3 pikë.

“Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë”- nga ana e gjyqtares janë paraqitur disa vërtetime ku rezulton se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, konkretisht pranë gjyqtares rezulton që të kenë ushtruar praktikën mësimore 4 studentë.

Sa më sipër është vlerësuar pikëzimi i saj, duke qenë se ka të dhëna, me 5 pikë.

Referuar sa më sipër, rezulton se gjyqtarja të jetë e angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi me 5 pikë.

Sa i përket “Publikimeve ligjore”, nuk rezulton që gjyqtarja të ketë gjatë periudhës së vlerësimit publikime ligjore. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi me 0 pikë.

Konkretisht, propozimi për kriterin e katërt është 93 pikë, "Shkëlqyeshëm".

Vlerësimi i përgjithshëm – propozimi për vlerësimin për të gjitha kriteret është si më poshtë: “Aftësia profesionale e gjyqtares” është 93 pikë, "Shkëlqyeshëm"; “Aftësia organizative”, 94 pikë, "Shkëlqyeshëm”; “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, 100 pikë, "Shkëlqyeshëm”; “Aftësia personale dhe angazhimi profesional”, 93 pikë, "Shkëlqyeshëm". Vlerësimi i përgjithshëm është 380 pikë, "Shkëlqyeshëm". Ky është propozimi.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Plaku!

Do kërkoja diçka që sipas rubrikave për të thënë në mënyrë të përmbledhur vlerësimin, domethënë “Aftësitë profesionale” "Shkëlqyeshëm", 93 pikë; “Aftësitë organizative”, "Shkëlqyeshëm”, 94 pikë; “Etika dhe angazhimi” 100 pikë.

Irena Plaku: Dhe “Aftësia personale dhe angazhimi profesional”, 93 pikë.

Niveli i përgjithshëm është "Shkëlqyeshëm" me 380 pikë.

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017-2019”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares znj. {...}, për periudhën 2017- 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;

C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Për më tej do vazhdojmë me pikën 10 të rendit të ditës, por për shkak të natyrës së saj, ajo do të zhvillohet me dyer të mbyllura. Kështu që në këtë moment ndërpritet komunikimi me të tretët për këtë mbledhje dhe do të vazhdojmë me dyer të mbyllura.

* * *

(Pika 9 të rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor